



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 09.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.10.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Mirusha Company**” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës**”- **Loti I-rë; Loti II-të & Loti IV-të, me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**Mirusha Company**”, e dt.02.10.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës**”- **Loti I-rë: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Skivjan; Loti II-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Shishmon dhe Loti IV-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Damjan**, me Nr. të Prok: **632-20-4174-5-1-1**, Nr. Brendshëm **632-20-063-511.**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 25.09.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: **25.09.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Meqë Operatori Ekonomik “Mirusha Company”., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës”- **Loti I-rë: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Skivjan; Loti II-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Shishmon dhe Loti IV-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Damjan,** me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-063-511, Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 09.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatorët Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k, Joos Krasniqi – Bazë sh.p.k. dhe Agim Morina B.I., i plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i eliminuar për arsye se ishte administrativisht i papërgjegjshëm dhe nuk plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës

